

RELACION

PËR

PROJEKTLIGJIT “PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES SË HUAS, NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE BANKËS NDËRKOMBËTARE PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM, PËR PROJEKTIN PËR LEHTËSIMIN E TREGTISË DHE TË TRANSPORTIT NË BALLKANIN PERËNDIMOR ME QASJE PROGRAMATIKE ME SHUMË FAZA”

I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Nëpërmjet këtij projektligji synohet ratifikimi i marrëveshjes së huas, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim, për projektin për lehtësimin e tregtisë dhe të transportit në Ballkanin Perëndimor me qasje programatike me shumë faza, në shumën prej 17 600 000 eurosh.

Objektivi kryesor i projektit është ulja e kostove të tregtisë dhe rritja e efikasitetit të transportit në Shqipëri përmes një angazhimi afatgjatë dhe të vazhdueshëm.

Projekti është pjesë e fazës së parë të një programi të përbashkët rajonal për vendet e Ballkanit Perëndimor, i cili synon të lehtësojë arritjen e qëllimit të qeverive përkatëse të këtyre vendeve për të ulur kostot e tregtisë dhe rritjen e efikasitetit të transportit përmes angazhimit afatgjatë, adaptiv dhe të vazhdueshëm.

Programi përfshin dy faza të cilat do të zbatohen për një periudhë pesë vjet secili.

Faza 1 mbulon 3 nga vendet e Ballkanit Perëndimor (Shqipërinë, Maqedoninë Veriore dhe Serbinë), të konsideruara gati për zbatim, dhe do të përfshijë një kombinim të investimeve, asistencës teknike dhe reformave rregullatore dhe institucionale.

Faza 2 e programit përfshin 3 vendet e tjera të rajonit: Bosnjën dhe Hercegovinën, Kosovën dhe Malin e Zi.

II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Ky projektligj nuk është përfshirë në programin analitik të akteve për vitin 2019.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Projektligji është planifikuar për t'u implementuar gjatë periudhës 2019 – 2025. Përparësitë për realizimin e këtij projekti janë të organizuara në 3 komponentë:

Pjesa 1. Lehtësimi i lëvizjes ndërkufitare të mallrave.
Këtu përfshihen:

- a) projektimi dhe instalimi i *National Single Window* (NSW);
- b) përmirësimi i kalimeve kufitare në korridoret tregtare të përzgjedhura.

Pjesa 2. Rritja e efikasitetit dhe parashikueshmërisë së transportit.
Këtu përfshihen:

- a) përgatitja dhe projektimi i sistemit inteligjent të transportit për sektorin detar (VTMIS);
- b) sigurimi, instalimi dhe komisionimi i pajisjeve për zbatimin e VTMIS.

Pjesa 3. Mbështetja për menaxhimin e projektit.

Mbështetja për menaxhimin e implementimit nënkupton mbështetjen e njësisë zbatuese të projektit dhe ofrimin e mbështetjes teknike shtesë, duke përfshirë koordinimin e politikave, monitorimin dhe vlerësimin e projektit.

Rezultatet e pritshme me realizimin e këtij projekti, të cilat janë të lidhura me objektivat e zhvillimit të tij gjatë fazës së parë, janë:

- reduktimi i kostove të tregtisë
- rritja e efikasitetit të transportit në Shqipëri, Maqedoninë e Veriut dhe Serbi.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Projektligji është hartuar në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121 të Kushtetutës.

Marrëveshja e huas është miratuar, në parim, nga Këshilli i Ministrave me vendimin nr.179, datë 4.4.2019, dhe është nënshkruar ndërmjet palëve. Në përputhje me ligjin nr.43/2016, datë 21.4.2016, "Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë", marrëveshja do t'i nënshtrohet procedurës së ratifikimit.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME ACQUIS COMMUNAUTAIRE (PËR PROJEKTAKTET NORMATIVE)

Ky projektligj nuk synon përafrimin e legjislacionit me *acquis communautaire*.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Projektligji parashikon ratifikimin e marrëveshjes së huas, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim, për projektin për lehtësimin e tregtisë dhe të transportit në Ballkanin Perëndimor me qasje programatike me shumë faza, në shumën prej 17 600 000 eurosh.

Objektivi kryesor i projektit është ulja e kostove të tregtisë dhe rritja e efikasitetit të transportit në Shqipëri përmes një angazhimi afatgjatë dhe të vazhdueshëm.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E PROJEKTAKTIT

Institucionet që ngarkohen për zbatimin e projektligjit janë Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Ministria e Brendshme.

VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Ky projektligj është përgatitur nga strukturat përkatëse pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Huaja që do të sigurohet nga Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (IBRD) është me termat e mëposhtëm:

Shuma:	17 600 000 euro;
Interesi:	bazuar në normën e referencës + marzh të pandryshueshëm;
Tarifa <i>Front-end</i> :	0.25% e shumës së huasë;
Komision angazhimi:	0.25% që përlogarit mbi vlerën e padisbursuar të huas;
Maturimi:	23 vjet, duke përfshirë periudhën prej 7 vitesh pa pagesë principali.

Ky projekt do të përfshihet në PBA 2019 – 2021.

KËSHILLI I MINISTRAVE